



Ref.: 1518/24 Datë: 05/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të në mbledhjen e 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programi e studimit të Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - o *Kujdesi dhe mirëqenia sociale BA 180 ECTS, me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Kujdesi dhe mirëqenia sociale BA 180 ECTS,</i>	Behxhet Gaxhiqi Ferdi Kamberi Shqipe Husaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Kujdesi dhe mirëqenia sociale BA 180 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Stavros Parlaris, Elene Jiblatze dhe Stefan-Marius Deaconu, është organizuar më 27.06.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4), Substancialisht dy (2) dhe pjesërisht një (1) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126-të, të mbajtur më datë 22.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

